

VENDIM
Nr. 93, datë 19.2.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1135, DATË 5.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, të ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:
 - a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:
“1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit përcaktohen si më poshtë vijon:
 - a) Për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat për krimin e organizuar dhe krimet e rënda dhe Policinë Shkencore, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
 - b) Për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat për sigurinë publike dhe rendin publik, sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
 - c) Për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat për kufirin dhe migracionin, sipas lidhjes nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
 - d) Për punonjësit e Policisë së Shtetit në struktura të tjera policore dhe administrative e mbështetëse sipas lidhjes nr. 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
 - b) Pika 5/1 ndryshohet si më poshtë vijon:
“5/1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, që pranohet në shkollën bazë të policisë, gjatë kohës së qëndrimit në shkollë përfiton trajtim me pagë, në masën 8000 (tetë mijë) lekë kur ka përfunduar arsimin e mesëm dhe 9000 (nëntë mijë) lekë kur ka përfunduar arsimin e lartë.”.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi për politikën e reja të pagave për Policinë e Shtetit, të parashikuara në buxhetin e vitit 2014.
 3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat në krimin e organizuar dhe krimet e rënda dhe Policinë Shkencore

Niveli	Grada	Shtesa per natyrrë të vecantë pune e shërbimi									
		Në funksione të Drejtorisë së Forcës së Posaçme, Oficerë të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda.	Në funksione të Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Njësia Speciale	Në funksione të Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve	Në funksione të Sektorit të Përpunimit të të Dhënave dhe Ndihmës në Drejtorinë e Mbrojtjes së Bashkëpunëtoreve të Drejtësisë.	Në funksione të Sektorit të Përpunimit të të Dhënave dhe Ndihmës në Drejtorinë e Mbrojtjes së Mbrojtjes së Dëshmitarëve	Në funksione të Policisë Shkencore.	Në funksione të Policisë Shkencore (nd. spec, komisarate dhe laborant), Teknologjia dhe Përgjimi.	Në funksione të Sektorit të Trafikeve, Krimit Ekonomik e Financiar, Aktive terroriste dhe Krimeve të Rënda.	Në funksione të Sektorit të Financës, Arkivit dhe Protokolit në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve	Në funksione të Sektorit të Shërbimeve Mbrojtëse për Departamentin për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda
	Paga bazë për gradë										
	Neminspektor	44500	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000
	Inspektor	49000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000
Niveli i zbatues	Kryeinspektor	54500	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000
Niveli i parë drejtues	Nenkomisar	65500	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000
	Komisar	72000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000
	Kryekomisar	87000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000
Niveli i mesëm drejtues	Drejtuës	99000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000
	Drejtuës i lartë	103000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

[illegible]

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

Niveli	Grada	Shtesa per natyrë të veçantë pune e shërbimi					
Niveli i zbatues							
	Neninspektor	44500	20000	Në funksione të Shërbimit të Krimit	Në funksione të shërbimit të kufirit dhe migracionit	Në funksione të shërbimit të komandimit dhe sallave operative, Shërbimi I qendrës	
	Inspektor	49000	20000	Shërbimet operationale dhe hetimit	Sektori I shërbimeve operationale ; Sektori I pritjes trajtimi dhe sigurisë në QP huajve	Qendrat e shërbimit të informacionit Sektori I rendit dhe sigurisë Trupë shërbimi ai dhe përgjegjës turni, në funksione të informacionit të ruajtjes së objektivit	3000
	Kryeinspektor	54500	20000				3000
Niveli i drejtues							
	Nenkomisar	65500	20000				3000
	Komisar	72000	20000				3000
	Kryekomisar	87000	20000				3000
Niveli i mesëm i drejtues							
	Drejtues	99000	20000				3000
	Drejtues i lartë	103000	20000				3000

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

Shtesa per natyrë të veçantë pune e shërbimi							
Niveli	Grada		Në funksione të mbështetëse në QFP, në drejtorinë e QPMDH, Sektorit/seksioni I marrëdhënieve me publikun , Seksioni Administrimit të dokumentet dhe përfaqësimit ligjor.	Në funksione të IPQP, Drejtoria e Standarteve Profesionale, Drejtor I QPMDH, Sektori I statistikave, në funksione të Help desk, dhe shërbimeve të IT.,	Në funksione të Studimeve strategjike, Drejtor I QFP, Sektori I Shkollimit bazë policor, Seksioni për trajtimin shkollimin e nivelit të parë, drejtues, Seksioni për trajnimin të shkollimin e nivelit të mesëm e të lartë drejtues në QFP.	Në funksione të Drejtorisë së Bashkëpunimit dhe koordinimit Ndërkombëtar, Asistent sekretari I Zv drejt të Përgjithshëm Shëf sektori asistent I drejtorit të PQ Tiranë.	Në funksione të Drejtorit të Përgjithshëm, Zëvendësdrejtor I Përgjithshëm, drejtor I Policisë së Qarkut Tiranë, komisarati.